



VENDIM

Nr. 153, Datë 11.12.2015

MBI

**OPERIMIN NË TREG TË PRODHUESVE ME KAPACITET TË
INSTALUAR NËN 1 MW DHE VETËPRODHUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në bazë të neneve 16; 18; 20, gërma a; 37 pika 6 gërma “b”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 10 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23, pika 4 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim Nr. 21 date 18.03.09, i ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike, në lidhje me operimin në treg të prodhuesve kapacitet të instaluar deri në 1 MW ;

Konstatohet se :

1. ERE merr vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike (neni 20, gërma a, i Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”)
2. ERE ndër objektivat e saj ka krijimi i kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut (Neni 18, pika “b” i Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
3. Çdo shoqëri tregëtare që dëshiron të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, mund t`a bëjë atë pa miratimin e ERE (Neni 37, pika 6, gërma “b”, i ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”).
4. Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë.(Neni 10 i Ligjit 8485 “Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”).

Vendosi :

- 1.** Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.
- 2.** Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajisen me licencë nga ERE.
- 3.** Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast që fillojnë të ushtrojnë veprimtari në Tregun e Energjisë Elektrike.
- 4.** Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të licencuarit KESH sh.a, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI